



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1012/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.P “Buli – Medical” – B.R. B.I., me nr. unik identifikues 811320522, me seli në Prishtinë, Veternik, Magjistratja Prishtinë-Gjilan, kundër debitorit “Kosovo Endocrine Group” Sh.P.K., me nr. unik identifikues 811475723, me seli në Ferizaj, adresa Talinoc i Jerlive, p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 220/23 i datës 25.05.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa me seli të zyrës në Gjilan, jashtë seancës, me datë 20.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Kosovo Endocrine Group” Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 220/23 i datës 25.05.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.T.P “Buli – Medical” – B.R. B.I., ka lëshuar Urdhrit përmbartimor P.nr.220/23 të datës 25.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit faturë nr.1529 e datës 21.08.2021, ashtu që është urdhëruar debitori që në emër të borxhit që rrjedh nga këto fatura t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 500.00 EUR (me shkronja: pesëqind euro), në afat prej shtatë (7) ditëve, me kamatë ligjore prej 8% sipas LMD-së si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrit Përmbartimor me arsyetimin se faturat të cilat i pretendon kreditori nuk janë pranuar nga ana e debitorit, pasi që të autorizuar për të nënshkruar për pranim të mallrave dhe faturave për debitorin kanë qenë pronarja e

kompanisë dhe drejtori menaxhues. Tutje ka shtuar se me caktimin e seancës dëgjimore do dokumentohen faktet se nënshkrimi në faturë nuk është nënshkrimi i personave të autorizuar për pranimin e mallrave nga ana e debitorit. Andaj ka kërkuar nga gjykata që ta hedh poshtë këtë propozim për përmbarim.

Kreditori, nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se fatura nr.1529 e datës 21.08.2021 në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar me rregull nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e vënë tek pranuesi i faturës, dhe e njejta i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë është e përshtatshme për përmbarim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbarimit.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se ndërmarrja “Buli-Medical” B.I është shuar andaj edhe propozimi për përmbarim duhet hedhur, por që në rastin konkret, kemi të bëjmë me një biznes individual, ku në mes të shoqërisë tregtare “Buli-Medical” B.I dhe pronarit të saj B.R. nuk ekziston një personalitet juridik i ndarë, kjo në kuptim të nenit 48, par.1 të Ligjit nr. 06/1 -016 për Shoqëritë Tregtare me të cilin parashihet se *“Një person mund të ketë vetëm një Biznes Individual. Personi i cili është pronar i një Biznesi Individual, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një Biznes Individual...”*. Mbi këtë bazë, Gjykata gjen se shuarja e biznesit individual, përveç që nuk paraqet pengesë që pronari i saj të përgjigjet personalisht për detyrimet që janë krijuar nga kjo shoqëri tregtare nuk paraqet as pengesë që pronari i biznesit individual, që të kërkoj realizimin e kërkesave të maturuara në emër të kësaj shoqërie tregtare, kjo pasi që të drejtat dhe detyrimet lidhur me biznesin në fjalë janë të drejta dhe detyrime të personit fizik.

Gjykata vlerësoi pretendimet tjera të debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t’i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1012/23, datë 20.12.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.